

Gjerdani i Shndritshëm

Karolina thjesht donte ta mbante gjerdanin pak më gjatë.



Nga Karolina Marini
(Bazuar në një ngjarje të vërtetë)

Kjo histori ndodhi në Argjentinë.

Karolina eci me të shpejtë nëpër oborr. Shoqja e saj, Izabela, ishte jashtë.

Izabela ia bëri me dorë. "Eja dhe luajmë!"

Karolina kaloi përmes oborrit drejt shtëpisë së Izabelës.

Izabela futi dorën në xhep. "Dua të të tregoj diçka", – tha ajo. Pastaj nxori gjerdanin më të bukur që Karolina kishte parë ndonjëherë! Gurët e vegjël

të çmuar ishin kaq të shndritshëm dhe shkëlqyes.

"Është e mamá-s sime", – tha Izabela. "Ajo tha se mund të luaja me këtë sot. Shikoje në diell."

Izabela e ngriti gjerdanin drejt dritës. Qindra ylbere u pasqyruan nga gurët e çmuar. Ishte kaq bukur!

"Tani le të luajmë hapa-dollapa", – tha Izabela.

"Në rregull", – tha Karolina. "Mund të të ndihmoj ta ruash gjerdanin."

"Faleminderit!" Izabela ia dha Karolinës gjerdanin dhe Karolina e futi në xhepin e saj.

Shpejt erdhi koha që Karolina të shkonte në shtëpi. Kur i tha mirupafshim, Izabela nuk ia kërkoi gjerdanin. Duhet të ketë harruar. Dhe Karolina nuk ia kujtoi.

Karolina u ndje disi keq që e mori gjerdanin në shtëpi. Por ajo donte ta mbante vetëm pak më gjatë. Ajo nuk e mori parasysh ndjenjën e keqe dhe e vuri gjerdanin nën jastëk.

Të nesërmen ishte e shtunë. Karolina bëri punët e saj të shtëpisë dhe shkoi të luante jashtë. E harrroi fare gjerdanin.

"Karolina", – thirri papá. "A mund të vish këtu?"

Karolina shkoi me vrap brenda. "Po?"

Papá mbante në dorë gjerdanin. "Mamá-ja e gjeti këtë nën jastëkun tënd. I kujt është?"

"Është i Izabelës." Karolinës iu mbushën sytë me lot. "Po e mbaja për siguri në xhep ndërkohë që luajtëm dje. Por pastaj vendosa ta merrja në shtëpi."

Mamá u ul me Karolinën në divan. "Faleminderit që the të vërtetën. Ç'mendon se duhet të bësh tani?"

Karolina ishte e heshtur. Ajo mendoi për Jezusin. Ai do të donte që të ishte e ndershme dhe ta kthente gjerdanin.

"Duhet t'ia kthej sërish Izabelës dhe t'i kërkoj falje", – tha Karolina. Sapo e tha këtë gjë, ndjenja e keqe iu largua. Ajo ndjeu ngrohtësi brenda vetes.

Karolina shkoi te shtëpia e Izabelës.

"Tjeta!" – tha Karolina. Ia dorëzoi Izabelës gjerdanin. "Më vjen keq që e mbajta këtë. A do të më falësh?"

"Po", – tha Izabela. "Faleminderit që e solle." Pastaj ajo buzëqeshi. "A do të luash sërish hapa-dollapa?"

"Po! Ti numëro e para. Unë po shkoj të fshihem."

Atë natë Karolina bëri një lutje. "I dashur Atë Qiellor, të lutem, më fal që

e mbajta gjerdanin. Dhe të falënderoj Ty që më ndihmove ta rregulloj këtë gjë."

Karolina e pati përsëri ndjenjën e ngrohtë. Ishte e gëzuar që mund të bënte atë që Jezusi donte që ajo të bënte. ●

UNË MUND TË PENDOHEM

Ne të gjithë bëjmë zgjedhje të gabuara nganjëherë. Por për shkak të Jezu Krishtit dhe Shlyerjes së Tij, ne mund të ndryshojmë dhe të bëjmë gjëra të drejta. Kjo gjë quhet pendim. Kur pendohemi, ne u kërkojmë falje atyre që i lëndojmë. Përpiqemi ta rregullojmë gabimin. Lutemi për falje. Bëjmë gjithçka mundemi që të mos e bëjmë atë zgjedhje të gabuar përsëri. Atëherë mund të falemi dhe të ndiejmë paqe nga Ati Qiellor.

